- Frikë lidhur me hospitalizimin dhe kërcënimin për vdekje.
- Rrezik nga perfuzioni jo efikas i indeve lidhur me zvogëlimin e rrjedhës së gjakut.
- Ndryshimet në perfuzionin e indeve si pasojë e zvogëlimit të rrjedhjes së gjakut,
- Përballje jo efikase lidhur me sëmundjen akute dhe me ndryshimet në stilin e jetesës.

- Mungesë e njohurive.

KUJDESI INFERMIEROR

Infermierja siguron një informacion për trajtimin e episodit të fundit të dhimbjes së krahavorit dhe medikamentet që pacienti ka administruar.

Kur pacienti nuk paraqet dhimbje të krahavorit infermiera siguron informacion për historikun e sëmundjes në familje dhe faktorët riskues, duke përfshirë zakonet në ngrënie, mënyra e jetesës dhe niveli i aktiviteteve fizike.

Vlerësimifizik

Infermiera vlerëson orientimin në kohë dhe hapësirë. Një humbje e vetëdijes do të thotë që zemra nuk jep sasinë e duhur të gjakut për të kënaqur kërkesat e trurit për oksigjen. Infermierja e inkurajon pacientin të përshkruajë shqetësimin e dhimbjes në krahavor, epigastër, nofull, shpinë apo krahë dhe i thuhet pacientit të tregojë shkallën e dhimbjes nga 1 deri në 10, ku 10 përbën nivelin më të lartë të diskomfortit. Pacienti shpesh e përshkruan diskomfortin si shtërngues, një ndjenjë djegëse, presioni apo mostretje. Infermieri pyet pacientin se çfarë ka bërë për lehtësimin e dhimbjes .

Vlerësimi i dhimbjes

Dhimbja e krahavorit mund të ketë shkaqe të ndryshme. Është shumë e rëndësishme të diferencohen tipet e dhimbjes së krahavorit dhe të identifikohen burimet që e kanë shkaktuar atë . Pyetjet që i drejtohen pacientit për sigurimin e informacionit për dhimbjen përfshijnë:

- Lokalizimin
- Përhapjen
- Intensitetin
- Kohëzgjatjen
- Faktorët që kanë shkaktuar dhe lehtësuar dhimbjen

Infermieri njëkohësisht shënon prezencën e çdo simptome të mëposhtme që shoqërohet:

- Nauze
- Të vjella
- Marrje mendsh
- Dobësi-frymëmarrje të shkurtër

Vlerësimipsiko-social

Refuzimi është shenja fillestare e dhimbjes së krahavorit në pacientët me angina apo infarkt të miokardit. Në përgjithësi pacientët me infarkt të miokardit presin më shumë se 2 orë pastaj drejtohen në spital. Pacientët shpesh i shpjegojnë simptomat e tyre si rezultat të mostretjes apo mbilodhjes . Në disa situata zemërimi është një pjesë normale e adaptimit për sa i përket identifikimit të simptomave ,siç është diskomforti i krahavorit.

Infermieri i shpjegon pacientit domosdoshmërinë e raportimit të çdo diskomforti, thekson se ai ose ajo duhet të përpiqet të lehtësojë diskomfortin në mënyrë të menjëhershme. Frika, ankthi dhe zemërimi janë reaksione të zakonshme të pacientëve dhe familjarëve. Vlerësimi infermieror fokusohet në identifikimin e këtyre ndjenjave. Infermieri lejon pacientin dhe familjarët të shpjegojnë si e kanë kuptuar sëmundjen .

QËLLIMET E KUJDESITINFERMIERORË

Lehtësimi i dhimbjes- Qëllimi kryesor është që pacienti të përjetojë një lehtësim të dhimbjes së krahavorit. Objektivi i trajtimit është të eliminojë diskomfortin e krahavorit nëpërmjet:

- Sigurimit të lehtësimit të dhimbjes,
- Zvogëlimin të kërkesave të miokardit për oksigjen,
- Rritjes së mëshitetjes së miokardit me oksigjen

Rritja e aftësiVe individuale për tu përshtatur me sëmundjen- Qëllimi është që pacienti të reduktojë ankthin, të shprehë ndjenjat e tij apo saj . Pacientët janë në gjendje të kontrollojnë disa aktivitete. Infermieri vlerëson nivelin e ankthit të pacientit ndërkohë që e lejon atë të shprehë ankthin dhe përpiqet të përcaktojë

origjinën e tij (Za. Përsëritja e shpjegimeve të terapisë, besimit dhe qëndrimit afër e ndihmon pacientin. Gjatë fazës akute të sëmundjes mjeku mund të përshkruajë medikamente anksiolitike. Infermieri identifikon problematikat e zakonshme të pacientit të cilat janë:

- Refuzimi
- Zemërimi
- Depresioni

Refuzimi është një mekanizem mbrojtës që lejon pacientin që të përdorë mekanizma për të përballuar kërcënimin. Kjo formë mospranimi zvogëlon ankthin e pacientit dhe infermieri nuk duhet ta disinkurajojë pacientin. Infermieri siguron qetësimin dhe shmang konfrontimet me pacientin, por me qetësi i tregon pacientit kur një sjellje është e dëmshme.

Zemërimi mund të jetë prezent kur pacienti të rimarrë veten. Infermieri inkurajon pacientin të shprehet dhe i siguron pacientit të marrë vetë vendime për gjendjen e tij.

Depresioni gjithashtu mund të jetë prezent. Infermieri dëgjon se si pacienti i shprehë ndjenjat e humbjes duke qenë të kujdesshem të mos ofrojë mbështetje fallco. Infermieri identifikon të gjitha përmirësimet e gjendjes së pacientit dhe i diskuton ato me vetë pacientin. Rritja e aftësisë për kryerjen e aktivitetit ditorë - Ky është qëllimi kryesor. Ky qëllim realizohet me anë të rehabilitimit kardiak i cili ndahet në tri faza:

1. Fillon me sëmundjen dhe përfundon me daljen nga spitali ,
2. Fillon pas lëshimit nga spitali dhe vazhdon në shtëpi,
3. I referohet vazhdimin të gjatë të trajtimit.

Në fazën e parë infermieri inkurajon pushim, por thekson edhe disa levizje të kufizuara. Infermieri ndihmon pacientin për kryerjen e disa aktiviteteve ditore si: banjo, lëvizjen nëpër korridore të vogla fillimisht me nga 100 hapa pastaj duke i shtuar aktivitetet si ky gradualisht. Infermieri në mënyrë të vazhdueshme vlerëson rrahjet e zemrës, presionin e gjakut dhe nivelin e lodhjes pas çdo aktiviteti.

KUJDESI INFERMIERORË PAS ANGIOPLASTIKES KORONARE

Kujdesi infermieror pas procedures së angioplastikes koronare në pacientët me IM është pothuajse i njëjtë edhe me pacientët që nuk kanë bërë ndërhyrje kirurgjike . Pasi angioplastika ka përfunduar, infermieri e transferon pacientin në dhomën e reanimacionit dhe e monitoron me EKG. Bëhet matja gjatë 5-6 orëve të para matja e TA dhe pulsit periferik. Pyetet vazhdimisht pacienti nëse ndjen dhimbje te gjoksit apo mos ka vështirësi në frymëmarrje. Shikohet shpesh vendi ku është bërë angioplastika për ndonjë gjakderdhje të papritur, nëse ka gjakderdhje atëherë duhet që infermieri të ushtroj presion për 30 minuta për ndalimin e saj dhe lajmërohet mjeku. Infermieri shikon për shtim të djerses, skuqjes apo nxehjes në zonen e ndërhyrjes. Vazhdimisht infermieri i jep informacion pacientit për procedurën e angioplastikes sepse kjo gjë ndikon në uljen e stresit dhe të frikës së pacientit. Përgatitja dhe edukimi shëndetsorë në shtëpi. Pacienti largohet nga spitali në shtëpi me një terapi dhe me aktivitete të caktuara nga mjeku. Qëndrimi në spital varet nga gjendja e pacientit .

EDUKIMI SHËNDETSORË

Infermieri identifikon nevojat e pacientit dhe të familjarëve për planin e përkujdesjes dhe e harton një të tillë:

- Të mësuarit për anatominë normale dhe fiziologjinë e zemrës,
- Patofiziologjinë e infarktit të miokardit,
- Faktorët e rrezikut të tij,
- Për aktivitetet e ushtrimit,
- Ndërprerjen e duhanit (për duhanpirësit),
- Dieta të kujdesshme,
- Marrjen e terapisë sipas përshkrimit të mjekut,
- Qëndrimin në shtëpi javën e parë pas daljes nga spitali,
- Infermieri i tregon metoda për reduktimin e stresit (lexim, t'i bie ndonjë vegje muzikore)

Infermieri luan një rol të rëndësishëm edhe në përgatitjen psikologjike të pacientit. Pacientët kanë nevojë për një mbështetje dhe mundësi ta shprehin pikëllimin, frikën dhe ankthin për sëmundjen e tyre .

VLERËSIMI I ARRITJEVE

Pacienti përjeton lehtësim apo eliminim të dhimbjeve

- Siguron ritmin normal të zemrës,
- Siguron TA, ritëm të frymëmarrjes dhe puls periferik normal ,
- Identifikon faktorët e rrezikut dhe planin për ndryshimet në mënyren e jetesës,
- Përshkruan se si mund të menaxhojë dhimbjen e krahërorit,
- Rritë aktivitetin në mënyrë graduale dhe kryen aktivitetet ditore duke mos përjetuar dhimbje të krahërorit, dispne apo lodhje.

#*RAST STUDIMI*

● Qëllimi i studimit është :

- Evidentimi i komplikacioneve tek pacientët që kanë kryer ndërhyrje.
- Menaxhimi i suksesshëm infermieror


● Materiali dhe metodat

- Studimi u krye ne repartin e terapisë intensive në spitalin e “ Nënë Tereza” Tiranë, në pavionin e kardio-kirurgjise.
- Në studim u morën 30 pacientë të cilët kishin kryer një ndërhyrje.

DIAGNOZAT

- | | |
|--|-------------|
| ➤ CABG x 1 | 2 pacientë |
| ➤ CABG x 2 | 4 pacientë |
| ➤ CABG x 3 | 10 pacientë |
| ➤ CABG x 4 | 4 pacientë |
| ➤ CABG x 1 (stenoze kritike e trungut komun) | 3 pacient |


- CABG x1 (insuficiencë mitrale e përparuar) 2 pacient
- CABG x 3(stenozë kritike të trungut komun) 3 pacientë
- CABG x 3 (insuficiencë mitrale e përparuar) 2 pacientë



grafiku i raportit F/M

SHPËRNDARJA SIPAS GRUPMOSHAVE


- Mosha 30-45 vjeçë 6 pacientë
- Mosha 45-60 vjeçë 14 pacientë
- Mosha 60-70 vjeçë 6 pacientë
- Mosha 70 vjeçë e lart 4 pacientë




grafiku i shperndarjes sipas grupmoshave

PATOLOGJITË SHOQËRUESE PREOPERATORE

- IM 10 pacientë
- HTA 20 pacientë
- DM tipi II 4 pacientë
- DM tipi I 5 pacientë



grafiku i patologjive shoqëruese



grafiku i paraqitjes se patogjise se IM

Rast klinik

Të dhënat subjektive - Burrë (B.V) 66-vjeç i lindur në Durrës me 19.06.1953. Pranohet në Njësi Koronare për shkak të dhimbjes së gjoksit. Dhimbja ka filluar gjatë aktivitetit fizik minimal, ka ndjenjën e rëndimit në gjoks, rrezaton në krahun

e majtë, shpinë dhe në nofullën e poshtme. Dhimbja ka filluar 30 minuta më parë dhe është e pranishme edhe në pranim. Dhimbja është e shoqëruar me temperaturë të lehtë, me frymëmarrje të vështirësuar, marramendje, nauze dhe djegie prapa ashtit të krahavorit.

Është hospitalizimi i parë. Në dy javët e fundit është ankuar në dhimbje gjoksi që janë shtrirë në krahun e majtë, në shpinë dhe në nofull. Dhimbjet janë lajmëruar gjatë aktivitetit fizik dhe janë qetësuar spontanisht në qetësi. Ka vite që trajtohet nga hipertension dhe çrregullimet e lipideve si dhe është duhanpirës. Babai vuan nga diabeti dhe hipertension, ndërsa e ëma vuan nga hipertensioni. Ka status socio-ekonomik mesatar. Nuk ka alergji në medikamente.

Të dhënat objektive - Në pranim pesha trupore 80 kg, me gjatësi 1.85cm. Shtypja e gjakut 180/110 mmHg, Puls 100 rrahje/min., Frymëmarrja 22/min. dhe temperatura 38°C. Lëkura dhe mukozat e dukshme të zbehta, i mbuluar në djersë dhe jep përshtypjen e të sëmuarit të rëndë.

Ekzaminimet plotësuese - Pas regjistrimit të EKG-së konsultohet mjeku dhe konstatohet elevim (ngritje) e segmentit ST në derivacionet D₂, D₃, AVF dhe në V₅ dhe V₆. Pra mjeku bën diagnozën e infarktit akut me elevim të segmentit ST dhe urdhëron pranimin në Njësi Koronare.

Përcaktimi i diagnozave Infermierore të pacientit

Qëllimi i diagnozës infermierore është hartimi dhe zhvillimi i një plani, kujdesi individual në mënyrë të tillë që pacienti dhe familja e tij të mund të përshtaten me ndryshimet që rezultojnë nga problemet shëndetësore. Pas mbledhjes së të dhënave subjektive, objektive, historike dhe aktuale, duke shfrytëzuar planin e procesit të kujdesit infermieror, diagnozat potenciale dhe të mundshme infermierore për këtë pacient janë :

- Dhimbje akute në gjoks e lidhur me inbalancën midis furnizimit dhe nevojave për oksigjen.
- Çrregullim i këmbimit të gazrave lidhur me rrjedhën e zvogëluar të gjakut në mushkëri.
- Frikë lidhur me hospitalizimin dhe kërcënimin për vdekje.
- Rrezik nga perfuzioni jo efikas i indeve lidhur me zvogëlimin e rrjedhës së gjakut.

- Ndryshimet në përfuzionin e indeve si pasojë e zvogëlimit të rrjedhjes së gjakut, -Përballje jo efikase lidhur me sëmundjen akute dhe me ndryshimet në stilin e jetesës.
- Mungesë e njohurive.

Planifikimi i kujdesit infermieror për pacientin me IAM

Qëllimi kryesor i rastit tonë është zvogëlimi i dhimbjes (nga 7/10 në 2/10) brenda 8 orëve të kujdesit infermior. Dhimbja e rëndë si pasojë e ndërprerjes së furnizimit me gjak të miokardit të prekur nga infarkti është shkaku kryesor i vdekjes nga sëmundja iskemike e zemrës në tërë botën.

Për këtë arsye intervenimi primar i infermierëve është vlerësimi i shenjave vitale siç është vlerësimi i shkallës së dhimbjes nëpërmes të grimasave të fytyrës dhe irritabilitetit, pastaj vlerësimi i hipertensionit arterial, dispnesë dhe palpitacioneve. Regjistrimi i fillimit, kohëzgjatjes, lokalizimit, karakterit dhe përhapjes së dhimbjes është gjithashtu e domosdoshme. Kjo do të mundësoi të bëhet dallimi i dhimbjes anginoze nga dhimbjet tjera të referuara. Dhimbja është monitoruar për çdo orë.

Së dyti, është rekomanduar oksigjenoterapia me urdhrin e mjekut për të relaksuar muskulin e zemrës (miokardin). Është gjithashtu me rëndësi që ti qëndrojmë pranë pacientit për të zvogëluar shkallën e ankthit me që kjo mund të rris ngarkesën e miokardit. Është udhëzuar për pushim të plotë në shtrat dhe pacienti është vendosë në pozicion gjysmë të ulur, në mënyrë që të zvogëlohen nevojat e miokardit për oksigjen. Zvogëlimi i parangarkesës dhe i pasngarkesës së zemrës e zvogëlon dhimbjen.

Administrimi i terapisë medikamentoze

Terapitë medikamentoze janë intervenime infermierore të varura dhe kërkojnë urdhrin e mjekut. Megjithatë, është e rëndësishme që të bëhet planifikimi i detajuar për përgjegjësitë e infermierit lidhur me administrimin e medikamenteve.

Nga antagonistët e agregacionit të trombociteve janë përdorur Aspirina dhe Clopidrogeli dhe që të dy janë ordinuar me rrugë orale. Përgjegjësitë infermierore gjatë administrimit të këtyre barërave janë që shpesh të monitorojë për gjakosje nga gingivat dhe për hematurit. Gjithashtu është me rëndësi të shmangen inhibitorët e pumpe protonike ngase kjo mund të çojë në reinfarkt. Duhet të monitorohet për zhurma në të dy anët e mushkërive dhe për thellësinë e

frymëmarrjes në mënyrë që të sigurohemi se oksigjenimi nuk është kompromituar nga dhënja e Morfinës për largimin e dhimbjes.

Nga medikamentet e tjera për zemrën janë administruar edhe Concor, Ramipril për trajtimin e hipertensionit.

Për rregullimin e lipideve dhe për stabilizimin e pllakës aterosklerotike është administruar Rosuwastatina.

Dalja ngaspitali i pacientit me IAM

Dalja e pacientit nga spitali evidenton një kujdes infermieror të suksesshëm. Pacientit i është rekomanduar konsulta me dietologun dhe me Specialistin për Rehabilitim Kardiak. Gjithashtu është udhëzuar për ndryshimet lidhur me stilin e jetesës dhe me monitorimin e faktorëve të rrezikut. I janë dhënë rekomandimet lidhur me ekzaminimin invaziv dhe me mundësi për revaskularizim.

Pacienti është informuar lidhur me terapinë në shtëpi dhe me nivelin e aktivitetit fizik deri në vizitën e kontrollit. Ai është njoftuar për mënyrën e përdorimit të Nitroglicerines dhe së bashku me familjarët janë edukuar për menaxhimin e situatës në rast të ndonjë emergjence.

Duke qenë se gjendja e përgjithshme dhe shenjat vitale kanë qenë stabile pacienti është liruar në shtëpi dhe i është caktuar termini për vizitë te Kardiologu pas dy javësh.

Rezultatet e studimit

Pacienti ka qenë duhan pirës. Pirja e duhanit është faktori më i madh i rrezikut për sëmundjet e zemrës . Pirja e duhanit mund të shkaktojë shtypjen e lartë të gjakut, përkeqësim të statusit të yndyrave, dhe mund të rrisë ngjitshmërinë e trombociteve, duke e rritur kështu rrezikun nga trombet . Ndërkohë, duhanpirësit janë në rrezik substancial për ndikimin në defektet e enëve të gjakut të cilat paraqesin rrezik për zemrën .

Duke pasur parasyshë rolin e tij si faktor rreziku, prania e hipertensionit në historinë e sëmundjes është e dhënë e shpeshtë tek pacientët me infarkt akut të miokardit . Edhe pacienti ynë në anamnezën e vet flet se është trajtuar nga hipertensioni. Një dëmtim mikrovaskular i rëndë dhe progresiv është i implikuar në patofiziologjinë dhe prognozën e pacientëve me histori për hipertension dhe me infarkt akut të miokardit.

Hulumtimet prospektive siç është hulumtimi i Framingham kanë bërë të qartë lidhshmërinë në mes të dislipidemive dhe sëmundjes iskemike të zemrës. Korrigjimi i dislipidemisë mund të zvogëlojë rrezikun nga infarkti i miokardit. Shkalla e rrezikut është edhe më e lartë kur dy apo më shumë faktorë të rrezikut janë të pranishëm tek individ. Edhe rasti ynë nuk bën përjashtim nga kjo.

Në mesin e prioriteteve të përgjithshme të pacientët me infarkt akut të miokardit është monitorim nga afër i shenjave vitale. Që në rastin tonë është ilustruar në mënyrë shumë korrekte.

Monitorimi i simptomave është gjithashtu me rëndësi për relaksim të pacientit dhe për largimin e ankthit që është i pranishëm të gjithë pacientët me infarkt akut të miokardit. Pacientët me rrezik të lartë duhet të menaxhohen në Njësine Koronare, aty ku monitorimi i vazhdueshëm kardial është i mundur.

Infermierët që menaxhojnë pacientët me infarkt akut të miokardit duhet të kenë njohuri bazike lidhur me EKG-në, që janë ndryshimet elektrokardiografike ose aritmitë me rrezik imediat për jetën e pacientit. Elemente të tjera të përkujdesjes infermiore tek pacientet me infarkt akut të miokardit nënkuptojnë kujdesin për rrugët venoze, linjën venoze qendrore, kateterët urinar dhe përkujdesjen për dekubituset. Kur pacienti të jetë i gatshëm për daljen nga spitali, parandalimi sekondar duhet të jetë në qendër të kujdesit infermior. Pacientët duhet të kuptojnë gjendjen e tyre, duhet të kurajohen për ndërrimin e nevojshëm të stilit të jetesës, pasi është themelor për parandalimin e rikthimit të sëmundjes. Ata do të lirohen nga spitali me shumë informacione, mirëpo e rëndësishme është që ti kuptojnë ato.

Konkluzione

Faktorët që nxisin infarktin akut të miokardit është stili jo i shëndetshëm i jetesës, si që janë: konsumimi i ushqimeve të pasura me yndyrna, me shumë kripë, mungesë të aktivitetit fizik, duhanpirja dhe të ngjashme të cilat i shkaktuan sulm në zemër pacientit. Pasi është e pranishme Dislipidemia, pacientit i është rekomanduar konsultimi me dietologun. Gjithashtu i është rekomanduar kontroll më i rregullt shtypjes së gjakut. I është sugjeruar një program rehabilitimi.

Rekomandimet

Duhet të sigurohemi se pacientit i janë dhënë udhëzimet e duhura lidhur me modifikimin e faktorëve të rrezikut për sëmundje koronare, si në vijim:

Të ndërpresë pirjen e duhanit dhe të mos qëndrojë në ambiente ku i ekspozohet duhanit (në shtëpi, në vendin e punës, ose në vende publike). Pacientit i është rekomanduar për këshillim për ndërprerjen e duhanit.

I është rekomandur për rregullimin e peshës së trupit me qëllim që të arrihet indeksi i masës trupore (BMI) në vlera optimale. Si qëllim fillestar i është rekomanduar të reduktoj peshën për 510% nga pesha bazë. Për këtë duhet të mbajë dietë dhe kryejë aktivitete të rregullta fizike.

Nga ky studim rasti ne rekomandojmë që mënyra e aplikimit të procesit infermieror nga ky studim, mund të përdoret në praktikën infermirore në sektorët e kujdesit shëndetësor për tu ofruar trajtim të duhur pacientëve me infarkt akut të miokardit dhe gjithashtu mund të shërbejë për edukim në kujdesin shëndetësor.

REFERENCA.

ACLS Institute 2016, 'Morphine', <<https://acls.com/free-resources/medicationmedicationdelivery/morphine>>.

Antman T, Armstrong E. Sëmundjet e zemres së Brunëaldit , (9th ed.). (Tirane,2015) fq. 1087–1110

Boegia MC, Medici F. Prospective in the treatment of dyslipidemia in prevention of coronary heart disease. Angiology 1998; 5: 339-48.

Colledge N. Ealke B, Hill S, Principet dhe praktikat mjeksore të Davidsonit,.(Shkup, 2015) (21st ed.) faqe 522-536.

David Carrick, Caroline Haig, Annette M. Maznyczka, et al. Hypertension, Microvascular Pathology, and Prognosis After an Acute Myocardial Infarction.

Hypertension. 2018;72:720-730.

Dandan H, Brunton L, Manuali I Goodman dhe Gilman per Farmakologji dhe Terapi (Shkup ,2015) fq. 291-298

Dioso, R. (11) 2014, 'Cigarette smoking among male teenagers in Malaysia: a narrative review', ASEAN Journal on Science and Technology for Development, vol. 31, no.1, pp.24–30.

Ëichbaum F ". Kardiologjia. (Prishtinë ,2010). fq 358–365

Faxon D "Kardiologjia klinike —(Tirane, 2015). fq,138–144

Goldberg G, Bonoë J., Vlersimi dhe menaxhimi i dhimbjeve të semundjet koronare,(Shkup, 2013) faqe 210-280

https://sq.wikipedia.org/wiki/S%C3%ABmundjet_e_zemr%C3%ABs

<https://shendeti.app/trajtime-mjekesore/angioplastika-koronare/>

Krasniqi Shkelzen. Kujdesi infermieror në infarktin akut të miokardit. Temë Diplome Master. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, 2014. Fq. 11.

McPherson, RA. & Pincus, MR 2011, 'Henry's clinical diagnosis and management by laboratory methods', 2. Clinical chemistry: cardiac injury, atherosclerosis and thrombotic disease, Elsevier Health Sciences, Medical—1568, <https://books.google.com>.

Nasir Behxheti, Selim Çerkezi, Argjent Muça” “Anatomia e Njeriut”. Tetovë, 2013. faqe90-91,94.

Peka E , Rrustami L, Bego E , Imami-Lelçaj D, Dervishi A , Zanaç A , Mane V , Infermiestika në specialitete , (Tiranë,2005),fq 46-47.

Reed T , Grant Ë , Jeffrey E; Cannon F, Christopher P Infarkti akut i miokardit . (Shkup, 2015). fq , 65.

Shkoza Artan” Fiziologjia e Njeriut botimi i III (Tiranë, 2009) . faqe 437-438.

St.Joh-Ambulance,ritish Red Cross,St.Adreë's Ambulance association. First Aid Manual Botimi I III(Përkthyer në Gjuhen shqipe) Faqe 118-126 Britani e madhe, 2002.

Vinay Kumar, Abul K.Abbas, Nelson Fausto, Richard N. Mitchell. Basic Pathology.

2007 Faqe 381.

World Health Organization, 1997. Encouraging People to Stop Smoking. Faqe 11.

Yusuf S, Hawken S, Ounpuu S, et al., INTERHEART Study Investigators. Effect of potentially modifiable risk factors associated with myocardial infarction in 52 countries (the INTERHEART study): case-control study. Lancet 2004; 364:937–952.

Zallari K , Koci R., Geriatria , (Tiranë,2003).

Tema: Formimi ne vazhdimesi I profesionit te infermierit dhe roli I tij ne tregun e gjere te punesimit.

Punoi MSc. Fabiola Mane

1. Prezantimi

Sektori i shëndetësisë në Shqipëri është një nga sektorët më të rëndësishëm dhe i shpallur vazhdimisht si prioritet për zhvillimin e vendit tonë. Pikërisht në bazë të kësaj rëndësie specifike edhe reformat bashkëkohore që do të ndërmerren në këtë sektor marrin një rëndësi të veçantë.

Ky studim fokusohet pikërisht në fushën e menaxhimit dhe të edukimit të vazhdueshëm Infermior dhe synon të vlerësojë cilësinë e shërbimit dhe mundësitë e përmirësimit të tij për të rritur produktivitetin dhe efikasitetin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri.

Objekti i hulumtimit ndalet në analizimin e situatës së sistemeve të menaxhimit në Sistemin Shëndetësor Shqiptar (duke marrë parasysh të dhënat faktike të spitalit rajonal të Durrësit të marra si rast studimi), por edhe më shumë, duke u krahasuar me modelet e tjera të përvojës ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, besohet se analiza e kryer më poshtë është shumë aktuale për një vend si Shqipëria, i cili kohët e fundit ka bërë përpjekje të mëdha për të vazhduar me realitetet e tjerëve. Konkretisht me poshte do të shpjegohen ato funksione trajnimi dhe organizative të zbatuara nga udhëheqesi infermior. Në fakt, përveçse të kenë aftësitë e duhura, ata duhet të kenë trajnimin e duhur, aftësinë për të transmetuar koncepte dhe për të koordinuar personelin. Megjithatë, duhet theksuar se në mënyrë që Koordinator i Infermierisë të kryejë plotësisht detyrat e tij, duhet të ketë edhe një sistem të mirëstrukturuar për ta mbështetur atë, sa më shumë të mungojë sistemi, aq më të mëdha janë përpjekjet për të arritur nivele të mjaftueshme të efikasitetit të kujdesit.

Literatura e konsultuar për përpunimin e punës nënvizon veçanërisht rëndësinë e lidershit Infermior në krijimin e mjediseve stimuluese të punës nga të cilat rrjedhin avantazhe të ndryshme si nga pikëpamja e punës ashtu edhe nga këndvështrimi i mirëpritjes së pacientëve. Në këtë mënyrë krijohen mjedise të shëndetshme pune, kemi përmirësim të kushteve të punës së infermierëve edhe nga pikëpamja psikologjike dhe përmirësim të aftësive për të menaxhuar pacientët.

Në dritën e kësaj, anketa synon të mbledhë dokumentacion dhe informacion mbi gjendjen aktuale dhe mbi evoluimin e pritshëm të sektorit në fjalë, duke iu referuar veçanërisht aspekteve të trajnimit dhe organizimit që janë thelbësore për rritjen e objekteve shëndetësore në përgjithësi. Është pikërisht trajnimi i vazhdueshëm i personelit shëndetësor ai që do të bënte të mundur nxitjen e ndryshimit në sjellje, duke respektuar objektivat e paracaktuara të trajnimit dhe duke garantuar cilësinë e asistencës së ofruar nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar në kohë.

Megjithatë, ne nuk duhet ta mendojmë sondazhin thjesht si një koleksion të dhënash, pasi pas analizimit të tyre mund të lindë nevoja për trajnime të metejshme të këtij lloji edukimi infermieror në Shqipëri dhe të hipotezohen skenarët e ardhshëm.

Është e nevojshme ndërgjegjësimi për këtë nevojë dhe mbi të gjitha për ata që kanë role vendimtare në kujdesin shëndetësor, siç është ai i edukuesit të vazhdueshëm të Infermierit në veçanti pra Koordinatorit Infermieror. Kjo figurë duhet të ketë mjetet e duhura për të kryer rolin e tij dhe duhet të drejtojë zgjedhjet e tij menaxheriale edhe sipas numrit të njerëzve drejt të cilëve ai drejtohet. Meqenëse Koordinatori i Infermierisë është një figurë referuese për një shumëllojshmëri njerëzish, ai duhet të sigurojë që puna të zhvillohet në një atmosferë stimuluese në mënyrë që stafi të nxitet gjithnjë e më shumë për të performuar më të mirën e tyre. Pikërisht nga këto supozime buron koncepti i menaxhimit infermieror dhe “shëndetit organizativ”, pra si aftësia e një kompanie shëndetësore, me kontributin themelor të drejtuesve dhe koordinatorëve të infermierisë, jo vetëm për të qenë efektive dhe produktive në aspektin shëndetësor, ofruar për përdoruesit, por edhe për t'u rritur dhe zhvilluar duke promovuar dhe ruajtur mirëqenien fizike dhe psikologjike të infermierëve.

Jam shumë i bindur se mjedisi stimulues është një parakusht i domosdoshëm për arritjen e rezultateve të rëndësishme, nëse individit i vetëm ndihet si ekip, pranon me vetëdije përgjegjësitë e tij dhe arrin të fokusohet në objektivat që duhen arritur, duke përmirësuar kështu punën e tij dhe performancën..

2. Qëllimi

Analiza e kryer ka objektiva të shumëfishta të ndërlidhura. Si vlerësimi, organizimi dhe strukturimi i figures së infermierit, nevojën për trajnim të personelit jo vetëm në lidhje me temat klinike të semundjeve por edhe të çështjeve të tjera të lidhura me to si ajo e menaxhimit të tyre. Konsiderohet e nevojshme të kuptohet se cili është perceptimi që kanë infermierët dhe koordinatorët në lidhje me të, në praktikë bëhet fjalë për përcaktimin e standarteve dhe protokolleve në lidhje me këtë çështje. Për më tepër, është e nevojshme të kuptohet rëndësia e figures së koordinatorit infermieror në edukimin e vazhdueshëm të infermierit, masën që Koordinatorët e Infermierisë janë të vetëdijshëm për rolin e tyre në trajnimin e bashkëpunëtorëve të tyre si personeli infermieror në përgjithësi dhe stafi mbështetës. Në këtë këndvështrim, Koordinatori i Infermierisë është ai që ndihmon rritjen e bashkëpunëtorëve të tij, krijon mundësi për zhvillim personal dhe profesional, lehtëson proceset mësimore dhe pushtimin e përgjegjësive dhe detyrave të reja.

3. Materialet dhe metodat

Për të arritur objektivat e përcaktuara në pikën e mëparshme, u krye një studim faktmbledhës në Spitalin e Përgjithshëm Shtetëror të Durrësit. Ky studim është i tipit observues dhe ka për qëllim

intervistimin e 40 koordinatorëve shëndetësorë aktivë brenda strukturës spitalore dhe qendrave shëndetsore të cilët e njohin mirë dinamikën e pranishme në të. Hetimi në praktikë u bë i qartë nëpërmjet përdorimit të një pyetësi të administruar në kampionin e Koordinatorëve të ekzaminuar.

Pas administrimit të pyetësit, Koordinatorët u ndërgjegjësuat për nevojën për të regjistruar përgjigjet dhe opinionet e tyre në lidhje me nivelin e trajnimit të Koordinatorëve Shëndetësor në Shqipëri. Në këtë kuadër, u sqarua se pyetjet e parashtruara nuk u përdorën aq shumë për të vlerësuar shkallën e përgatitjes së koordinatorëve shëndetësorë, sa për të vlerësuar boshllëqet e trajnimit dhe organizimit ndaj të cilave duhet kushtuar vëmendje për të parashikuar një përmirësim në të ardhmen. Më tej, për të krijuar një atmosferë të qetë dhe për të lehtësuar marrjen e informacionit të dobishëm për punën, u prezantua dhe e bëra të qartë personalisht se cili ishte objektivi i punës, duke specifikuar gjithashtu se do të ruhej anonimiteti.

4. Pyetësi i administruar

Në qasjen me të cilën vendoset pyetësi është thelbësore të kujdesemi për dinamikën psikologjike, duke krijuar kushtet ideale në mënyrë që i intervistuari të sigurojë numrin më të madh të informacionit të besueshëm, duke marrë parasysh aspektet komunikuese të intervistuesit dhe mbi të gjitha variablat psikologjike, motivuese, të sjelljes dhe socio-kulturore që mund të ndikojnë tek bashkëbiseduesi.

Për sa i përket pyetësit të strukturuar, janë përdorur pyetje me zgjedhje të shumëfishta në të cilat mund të tregohen vetëm një ose maksimumi tre preferenca. Pyetësi është gjithashtu i vetë-administruar, në fakt, pasi u paraqit përdoruesve dhe duke i vënë në dijeni ata, pyetësit plotësoheshin spontanisht. Së fundi, për të mos krijuar frikë, pyetësit u plotësuan në mënyrë anonime, duke mos krijuar asnjë gjurmueshmëri të përdoruesit të përfshirë drejtpërdrejt në sondazh. Në këtë mënyrë Koordinatorët u ndjenë të lirë, nëpërmjet përgjigjeve të tyre, të identifikonin elementët e trajnimit që ata i konsideronin më të përshtatshëm në lidhje me përvojën e tyre aktuale dhe të mëparshme, ata gjithashtu mundën të tregonin aspektet e nevojshme për ndryshim në sistemin aktual të trajnimit.

Duke hyrë në specifikat e pyetjeve të parashtruara, siç do të shihet më poshtë, pyetësi u nda në tre pjesë, e para lidhej me klasifikimin e të intervistuarit, e dyta synonte identifikimin e ndërgjegjësimit që kanë koordinatorët e infermierisë në lidhje me rolin e tyre brenda institucionit shëndetësor dhe e treta në lidhje me nivelin e trajnimit.

Pyetjet në lidhje me klasifikimin e kampionit të anketës janë të nevojshme për të bashkuar përdoruesit e ndryshëm në grupe homogjene sipas përvojës së punës, trajnimit bazë dhe post-bazë dhe përvojës së mëparshme të punës. Në pjesën e dytë të analizës, nga ana tjetër, do të përpiqemi të identifikojmë se cila është radha e prioritetit për Koordinatorët, si i kryejnë funksionet e tyre menaxheriale dhe ekzekutive dhe si zbatojnë procesin e trajnimit të vazhdueshëm. Në pjesën e tretë, nga ana tjetër, do të identifikohet niveli i trajnimit i perceptuar dhe i pritshëm.

INKUADRIMI I ANKETËS

1. EKSPERIENCA E PUNËS

- a) 3-7 vjet
- b) 8-10 vjet
- c) 11-15 vjeç
- d) mbi 15 vjet (shih grafikun 3.1)

2. EKSPERIENCA PUNË TË MËPARSHME

- a) Zona e urgjences
- b) Zonë e poliklinikes
- c) Zona kirurgjikale
- d) Ambulanca shendetsore (shih Grafikun 3.2)

3. TRAJNIM BAZË

- a) Kurse shtetërore ose të ngjashme
- b) Diplomë e marrë në Shqipëri
- c) Diplomë e marrë jashtë vendit (shih grafikun 3.3)

4. TRAJNIM POST BAZË

Tregoni kualifikimin e marrë (për shembull master, kurse specializimi, etj., ..)

PROCEDURAT E ZBATIMIT TË PROCESIT TE TRAJNIMIT

5. CILAT MENDONI SE JANE FUSHAT MË TË RËNDËSISHME TË TRAJNIMIT PËR NJË INFERMIER KOORDINATUES (maksimumi tre përgjigje)

- a) Koordinimi i trajnimeve
- b) Drejtimi dhe kontrolli i punës së infermierëve vartës
- c) Menaxhimi i konflikteve të brendshme
- d) Kërkimi dhe cilësia
- e) Teknikat e infermierisë
- f) Menaxhimi i infermierisë (shih Figurën 3.4)

6. CILAT AFTËSI I KONSIDERONI THEMELORE PËR NJË PERFORMANCË OPTIMALE TË ROLIT TË KOORDINATORIT? (maksimumi tre përgjigje)

- a) Trajnimi i bashkëpunëtorëve
- b) Menaxhimi i konflikteve
- c) Dëgjimi dhe komunikimi
- d) Risite
- e) Organizimet
- f) Planifikimet

- g) Analiza e bashkëpunëtorëve
- h) Analiza e kontekstit (shih grafikun 3.5)

7. CILAT KARAKTERISTIKA INDIVIDUALE I KONSIDERONI THEMELORE PËR NJË PERFORMANCE OPTIMALE TË ROLIVE TË KOORDINATORIT? (maksimumi tre përgjigje)

- a) Përvoja
- b) Autoriteti
- c) Përshtatshmëria
- d) Ndjeshmëria
- e) Fleksibiliteti
- f) Disponueshmëria
- g) Intuita
- h) Reflektimi
- i) Kreativiteti
- l) Ndërgjegjësimi për rolin
- m) Vetë-trajnimi
- n) Autokritikë
- o) Vetë-motivimi (shih grafikun 3.6)

8. ÇFARË AKTIVITETI KRYERNI PËR TRAJNIMIN E VAZHDUESHËM TË BASHKËPUNËTORËVE TUAJ? (maksimumi tre përgjigje)

- a) Bashkëpunimi me zyrën e trajnimit
- b) Programoni aktivitetet dhe turnet
- c) Zbulimi i nevojave për trajnim
- d) Vlerësimi i recidivave
- e) Veprimtaritë mësimore ose kujdestare për kurse
- f) Të tjera (shih grafikun 3.7)

9. SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILAT NGA KËTO AKTIVITETET TRAJNIMORE JANË KOMPETENCA E KOORDINATORIT INFERMIEROR? (maksimumi tre përgjigje)

- a) Vlerësimi i kënaqësisë
- b) Vlerësimi i recidivave
- c) Përcaktimi i nevojave për trajnim
- d) Përcaktimi i objektivave të trajnimit (shih Grafikun 3.8)

10. SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILI NGA KËTO ASPEKTE ËSHTË THEMELOR PËR TRAJNIM?

- a) Përvoja e nxënësit
- b) Përvoja e mësimdhënies
- c) Metoda didaktike

- d) Mjet didaktik
- e) Përmbajtja e transmetuar
- f) Të tjera (shih grafikun 3.9)

11. SIPAS MENDIMIT TUAJ CILAT JANË ASPEKTET QË FAVORIZOJNE MOTIVIMIN E PUNËS TUAJ?

- a) Njohja sociale
- b) Aftësia për të udhëhequr të tjerët
- c) Aspekti i shpërblimit
- d) Fuqia
- e) Vetëvlerësimi (shih grafikun 3.10)

12. SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILAT JANË ASPEKTET QË FAVORIZOJNË MOTIVIMIN E BASHKËPUNETOREVE TUAJ PËR TË MËSUAR?

- a) Aspekti i shpërblimit
- b) Të ketë rregulla për të ndjekur dhe pak përgjegjësi
- c) Të ndjehet i mbështetur dhe inkurajuar moralisht
- d) Te veproje në mënyrë të pavarur dhe me përgjegjësi në bashkëpunim me kolegët dhe eprorët (shih Grafikun 3.11)

NIVELI I TRAJNIMIT I PERCEPTUAR DHE I PRITUR

13. SIPAS MENDIMIT TUAJ SI DO TË PËRKUFIZONI SHKALLËN E PJEKURISË NË BASHKËPUNËVE TË TUAJ?

- a) Pjekuria e ulët: punonjësi është i papërvojë, i pasigurt dhe nuk është i disponueshëm
- b) Pjekuria mesatare - e ulët: punonjësi është i papërvojë, por dëshmon të jetë i disponueshëm dhe me vetëbesim
- c) Pjekuria mesatare e lartë: bashkëpunëtori është me përvojë, por i pasigurt dhe nuk rezulton të jetë i disponueshëm
- d) Pjekuria e lartë: punonjësi është me përvojë / kompetent dhe i disponueshëm / vetëbesim. (shih grafikun 3.12)

14. SIPAS MENDIMIT TUAJ A KANË MJETET E NEVOJSHME KORDINATORËT INFERMIERORE NË SHQIPËRI PËR TË FAVORIZUAR RRITJEN E NIVELIT TË TRAJNIMIT TË EKIPIT?

- a) Po
-

- b) JO
- c) Po, por nevojiten ndryshime
- d) Jo, edhe nëse diçka po përmirësohet. (shih grafikun 3.13)

15. SIPAS MENDIMIT TUAJ CILAT JANË PROBLEMET QË KANE PENGUAR PUNËN E KOORDINATORËVE INFERMIERORE DERI SOT?

- a) Mos-Organizimi i sistemit shëndetësor
- b) Stimuj të dobët për trajnime dhe kërkime
- c) Politikat armiqësore dhe vështirësitë socio-ekonomike
- d) Komunikimi i dobët ndërmjet pjesës së brendshme të strukturës dhe organeve të jashtme përgjegjëse për trajnimin. (shih grafikun 3.14)

16. NË MENDIMIN TUAJ CILI ËSHTË NIVELI I TRAJNIMIT TË KOORDINATORËVE NGA PËRVOJAT E TRAJNIMIT TË FITUARA JASHTË KUFIJVE TERRITORIAL?

- a) Më e ulët se ajo e Koordinatorëve të trajnuar në Shqipëri
- b) Superior ndaj atij të Koordinatorëve të trajnuar në Shqipëri
- c) Ngjashëm me atë të Koordinatorëve të trajnuar në Shqipëri
- d) Zgjerimi i njohurive përtej kufijve territorialë bën të mundur pasurimin e njohurive të secilit. (shih grafikun 3.15)

17. SIPAS MENDIMIT TUAJ SA KA NDRYSHUAR NE VITET E FUNDIT NE SHQIPERI,VËMENDJAQE I KUSHTOHEJ EDUKIMIT TE VAZHDUAR?

- a) Ka mbetur i pandryshuar
- b) Është ulur
- c) Është rritur
- d) Nuk e di (shih grafikun 3.16)


18. SIPAS MENDIMIT TUAJ CILAT JANË NDËRHYRJET QË DUHEN ZBATUAR PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË ARDHSHEM TË TRAJNIMIT?

- a) Koordinimi ndërmjet kurseve
- b) Investimet në kërkime
- c) Përmirësimi i përmbajtjeve të deklaruara
- d) Prezantimi i sistemeve të reja didaktike (shih grafikun 3.17)


5. Rezultatet


Për të lehtësuar leximin e rezultateve dhe transferimin e tyre më të menjëhershëm, u realizuan analizat dhe më pas u paraqitën grafikisht në Excel. Siç u përmend më parë, pyetësorët u plotësuan nga 40 njësi spitalore.

Pjesa e parë e pyetësorit, që lidhet me klasifikimin e kampionit të anketimit, bëri të mundur identifikimin e profilit tipik të Koordinatorëve që iu përgjigjën pyetjeve: shumica e tyre kanë rol nga 11 deri në mbi 15 vjet, shumë prej tyre, veçanërisht ata me vjetërsi më të lartë profesionale kanë fituar këtë kualifikim përmes kurseve shtetërore ndërsa ata që kanë marrë një kurs diploma jashtë vendit janë në pothuajse të gjitha rastet e atyre që kanë më pak vite shërbimi. Kampioni hulumtuar vjen, si përvojë e mëparshme pune, në mënyrë mjaft homogjene, nga fusha kirurgjencat, mjekësore- klinike dhe kirurgjikale.




Grafiku 3.1





Grafiku 3.3

Për sa i përket pjesës së dytë të pyetësorit, në lidhje me procedurat e zbatimit të procesit të trajnimit, prej tij del fotografia e përshkruar nga histogramet e mëposhtme. Në veçanti, shumica e përdoruesve të përfshirë në hetim e njohin rolin kyç të Koordinatorit si përgjegjës për menaxhimin jo vetëm të menaxhimit infermieror në përgjithësi, por edhe mbi të gjitha konfliktet e brendshme brenda ekipit (29%). Nga ana tjetër, nuk i jepet një peshë e veçantë aftësive të qenësishme në teknikat e infermierisë (9%), kjo ndoshta sepse njohja e përsosur e temës është një përfundim i paramenduar për një Koordinator.




Grafiku 3.4

a) 10% Koordinimi i trajnimeve, b) 20% Drejtimi dhe kontrolli i punës së infermierëve vartës

- c) 29% Menaxhimi i konflikteve të brendshme, d) 10% Kërkimi dhe cilësia,
e) 9% Teknikat e infermierisë, f) 22% Menaxhimi i infermierisë


Përparësia që i atribuohet menaxhimit të konflikteve të brendshme reflektohet edhe në pyetjen që ka të bëjë me aftësitë themelore të Koordinatorit, ndër të cilat, përveç planifikimit dhe organizimit, shfaqet edhe aftësia për të dëgjuar dhe lidhur me aftësitë e nevojshme për tejkalimin e potencialit.



Grafiku 3.5

- a) 12% Trajnimi i bashkëpunëtorëve, b) 15% Menaxhimi i konflikteve, c) 16% Dëgjimi dhe komunikimi, d) 8% Risite, e) 15% Organizimet, f) 16% Planifikimet, g) 3% Analiza e bashkëpunëtorëve, h) 15% Analiza e kontekstit


Duhet theksuar se ka edhe një farë ndjeshmërie ndaj trajnimit, përpos rendesise se trajnimit të infermiereve, në fakt del se Koordinatori duhet të jetë me i vetëdijshëm për rolin e tij i cili ushqehet si nga përvoja e tij ashtu edhe nga trajnimi i tij bazë. Për të kryer rolin formues në mënyrën e duhur, Koordinatori nuk mund të mbështetet vetëm në përvojën e tij, por duhet të jetë gjithmonë në gjendje të përmirësojë veten në mënyrë që të transferojë nocione të rëndësishme te të tjerët.



Grafiku 3.6

a) 31%Përvoja, b) 2%Autoriteti, c) 1% Përshtatshmëria d) 2%Ndjeshmëria e) 3% Fleksibiliteti f) 7% Disponueshmëria g) 2% Intuizioni h) 2% Reflektimi i) 2% Kreativiteti l) 19% Ndërgjegjësimi për rolin m) 13% Vetë-trajnimi n) 3% Autokritikë, o)13% Vetë-motivimi.

Pavarësisht rëndësisë së trajnimit, roli i Koordinatorit, siç shpjegohet në histogramin e mëposhtëm, shpesh shprehet si një organizim i thjeshtë i ndërrimeve të turneve të punës (38%). Në fakt, janë të paktë ata që janë të përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetet e tutorizimit dhe mësimdhënies dhe për këtë arsye janë në gjendje të marrin pjesë edhe në aktive të tjera për përvetësimin e aftësive.




Grafiku 3.7

a) 15% Bashkëpunimi me zyrën e trajnimit b) 38% Programon aktivitetet dhe turnet


c) 16% Zbulimi i nevojave për trajnim d) 16% Vlerësimi i recidivave e) 10% Veprimtaritë mësimore ose kujdestare për kurse f) 5% Të tjera (shih grafikun 3.7)

Nga pikëpamja e trajnimit, del gjithashtu se Koordinatorët e kuptojnë rëndësinë e të qenit në gjendje për të kuptuar boshllëqet e trajnimit në grupin e tyre të punës si dhe për të identifikuar nevojat për trajnim. Pasi të jenë identifikuar nevojat për trajnim bazuar në boshllëqet e shfaqura, Koordinatorët para së gjithash e konsiderojnë të nevojshme të identifikojnë përmbajtjet e duhura për t'u transmetuar dhe menjëherë më pas të marrin në konsideratë përvojën e mësimdhënies, metodën e mësimdhënies dhe mjetin themelor të mësimdhënies për trajnim.



Grafiku 3.8


a) 10% Vlerësimi i kënaqësisë b) 26% Vlerësimi i recidivave
c) 37% Përcaktimi i nevojave për trajnim d) 27% Përcaktimi i objektivave të trajnimit



Grafiku 3.9


a) 7% Përvoja e nxënësit b) 21% Përvoja e mësimdhënies c) 20% Metoda didaktike d) 20% Mje didaktik e) 28% Përmbajtja e transmetuar f) 4% Të tjera

Për sa i përket dy pyetjeve të fundit të pjesës së dytë të pyetësorit, ne kemi dashur të fokusohem në aspektet motivuese që lidhen me rolin e Koordinatorit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Për këtë qëllim, janë bërë dy pyetje identike dhe spekulare lidhur me aspektet motivuese të njërës dhe tjetrës kategori, të perceptuara nga Koordinatorit i Infermierisë. Për Koordinatorët është një motiv rëndësishëm që të kenë mundësinë e orientimit të bashkëpunëtorëve të tjerë, prandaj ata janë plotësisht të vetëdijshëm për funksionin e tyre drejtues brenda kontekstit të kujdesit shëndetësor në të cilin janë futur. Nga ana tjetër, ata njohin si një aspekt motivues për bashkëpunëtorët e tyre mbi të gjitha mundësinë që ata kanë për të fituar autonomi teksa mësojnë koncepte të reja, trajnim në praktikë shihet si një mjet që gjeneron aftësi për vetëvendosje.




Grafiku 3.10

a) 19% Njohja sociale b) 37% Aftësia për të udhëhequr të tjerët c) 6% Aspekti i shpërblimit d) 8% Fuqia e) 30% Vetëvlerësimi



Grafiku 3.11

- a) 6% Aspekti i shpërblimit b) 19% Të ketë rregulla për të ndjekur dhe pak përgjegjësi
 c) 30% Të ndjehet i mbështetur dhe inkurajuar moralisht
 d) 45% Te veproje në mënyrë të pavarur dhe me përgjegjësi në bashkëpunim me kolegët dhe eprorët.



Grafiku 3.12

- a) 2% Pjekuria e ulët: punonjësi është i papërvojë, i pasigurt dhe nuk është i disponueshëm
 b) 26% Pjekuria mesatare - e ulët: punonjësi është i papërvojë, por dëshmon të jetë i disponueshëm dhe me vetëbesim
 c) 27% Pjekuria mesatare e lartë: bashkëpunëtori është me përvojë, por i pasigurt dhe nuk rezulton të jetë i disponueshëm
 d) 45% Pjekuria e lartë: punonjësi është me përvojë / kompetent dhe i disponueshëm / vetëbesim.

Mbi bazën e teorisë së mësipërme, një qasje e ndryshme nga udhëheqja e Koordinatorit të Infermierisë mund të përputhet me çdo nivel pjekurie të regjistruar. Ky model ju lejon të analizoni nevojat e njerëzve të përfshirë në situatën në të cilën ndodheni dhe për këtë arsye të përdorni herë pas here stilin më të përshtatshëm të udhëheqjes. Prandaj, sipas kompetencave të njerëzve dhe punës së tyre, modaliteti i udhëheqjes duhet të ndryshojë jo vetëm nga personi në person, por edhe për të njëjtin person, ndonjëherë në një mënyrë të caktuar, ndonjëherë në një tjetër. Në analizën specifike, Koordinatorët pretendojnë se kanë një pjesë të bashkëpunëtorëve me një nivel maturimi mes të ulët dhe të lartë.


Për sa i përket kufijve të jashtëm të lidhur me mjetet e vëna në dispozicion për rritje, përpos gjithë arritjeve të mëdha të kryera vitet e fundit në sistemin shëndetësor, vihet re se ka një pakënaqësi për shumë Koordinatorë që kërkojnë trajnime të përditësuara, pa kërkuar kështu lëvizjen e tyre nga ambientet e punës. Ka edhe dikush që megjithatë i kupton me optimizëm ndryshimet e viteve të fundit që synojnë përmirësimin e nivelit arsimor dhe edukues të infermierit..



Grafiku 3.13

- a) 6% Po b) 36% JO c) 38% Po, por nevojiten ndryshime
d) 20% Jo, edhe nëse diçka po përmirësohet.


Megjithatë, shumica e të intervistuarve ndanë idenë se faktori kryesor kufizues i punës së koordinatorëve të infermierisë qëndron në politikat dhe problemet socio-ekonomike të vendit të shoqëruara nga stimujt e paktë që ofrohen për kërkime shkencore. Megjithatë, jo më pak i rëndësishëm është edhe denoncimi për mos-organizim të sistemit shëndetësor.



Grafiku 3.14

- a) 25% Mos-organizimi i sistemit shëndetësor b) 26% Stimuj të dobët për trajnime dhe kërkime
 c) 39% Politikat armiqësore dhe vështirësitë socio-ekonomike
 d) 12% Komunikimi i dobët ndërmjet pjesës së brendshme të strukturës dhe organeve të jashtme përgjegjëse për trajnimin.

Denoncimi ndaj sistemit social, ekonomik dhe ndaj organizatave shëndetësore shkon paralelisht me nevojën që Koordinatorët ndjejnë për të rritur nivelin e trajnimit, për të inkurajuar kërkimi shkencor dhe për t'u hapur ndaj vendeve të tjera.




Grafiku 3.15

- a) 6% Më e ulët se ajo e Koordinatorëve të trajnuar në Shqipëri
 b) 7% Superior ndaj atij të Koordinatorëve të trajnuar në Shqipëri
 c) 39% Ngjashëm me atë të Koordinatorëve të trajnuar në Shqipëri


d) 48% Zgjerimi i njohurive përtej kufijve territoriale bën të mundur pasurimin e njohurive të secilit.

Pavarësisht vështirësive të hasura në Shqipëri, Koordinatorët megjithatë shënuan një rritje të vëmendjes ndaj trajnimit të vazhdueshëm (49%).



Grafiku 3.16

a) 39% Ka mbetur i pandryshuar b) 5% Është ulur c) 49% Është rritur, d) 7% Nuk e di



Grafiku 3.17

a) 3% Koordinimi ndërmjet kurseve
 b) 38% Investimet në kërkime
 c) 38% Përmirësimi i përmbajtjeve të deklaruara
 d) 21% Prezantimi i sistemeve të reja didaktike.

6. Konkluzioni

Sondazhi synoi të hedhë dritë mbi situatën aktuale të edukimit të inermierit dhe të Koordinatorëve të Infermierisë në vecanti duke mbledhur fillimisht informacion në lidhje me veçoritë e punës së të intervistuarve, më pas duke identifikuar disa karakteristika të realitetit në të cilin ata janë futur, duke vënë theksin në shkallën e kënaqësisë dhe zhgënjimit ndaj të sistemit.

Të dhënat e mbledhura çojnë në gjurmimin e profilit mesatar të të intervistuarit si njerëz me përvojë mesatare të lartë, të alokuar në një kontekst mjaft kompleks spitalor, në të cilin ata aspirojnë për një trajnim më të gjerë dhe më të përditësuar, veçanërisht për çështjet menaxheriale, për udhëheqjen, për menaxhimin e konflikteve dhe në kërkime, pa anashkaluar çështjet klinike - mirëqenies.

Megjithatë, realiteti që u shfaq është i papajtueshëm në lidhje me një pikë themelore: Koordinatorët janë shumë të qartë për faktin se nevojitet një ndryshim organizativ për të inkurajuar trajnimin e vazhdueshëm, por shpesh ata nuk kanë mjetet, materialet dhe sistemet organizative në dispozicion për të arritur nivelet e dëshirueshme të trajnimit. Dëshira për të rritur procesin e formimit është gjithnjë e më e fortë dhe e jetuar me përkushtim rigoroz sidomos nga më të rinjtë, pra nga ata që janë bërë Koordinatorë për një kohë më të shkurtër. Këta të fundit, shpesh edhe me nivele më të larta arsimimi, janë ata që përputhen me suksesin e figurës së Koordinatorit jo aq me përvojën, sa me aftësinë për të qenë të përditësuar dhe për të përvetësuar gjithmonë aftësi të reja.

Trajnimi i vazhdueshëm i personelit shëndetësor do të bëjë të mundur nxitjen e ndryshimit në sjellje dhe rritjen e cilësisë së kujdesit në kohe, por edhe për të rritur dhe zhvilluar mirëqenien fizike dhe psikologjike të infermierëve si dhe duke rritur mundësitë e tyre të punësimit në rajon e me gjere.

BIBLIOGRAFI

1. Modi Al-Moteri - **Implementing Active Clinical Training Approach (ACTA) in clinical practice** PMID: 33130540
2. Michelle Pavloff, Mary Ellen Labrecque- **Continuing Education for Home Care Nurses: An Integrative Literature Review.** PMID: 34738966
3. Katja Pursio, Päivi Kankkunen, Ericka Sanner-Stiehr, Tarja Kvist- **Professional autonomy in nursing: An integrative review.** PMID: 33548098
4. Trude Furunes, Anita Kaltveit, Kristin Akerjordet- **Health-promoting leadership: A qualitative study from experienced nurses' perspective.** PMID: 29987859
5. Pamela Brady Germain, Greta G Cumming- **The influence of nursing leadership on nurse performance: a systematic literature review.** PMID: 20609047
6. Merrick Zwarenstein, Joanne Goldman, Scott Reeves- **Interprofessional collaboration: effects of practice-based interventions on professional practice and healthcare outcomes.** PMID: 19588316
7. Deli Salini. **PRATICA INFERMIERISTICA E INNOVAZIONE DIGITALE** Rapporto conclusivo del progetto regionale 2018-2019
8. **Nursing: verso un mondo in salute attraverso la leadership.** Professor Jill White, Professor Emerita of the Faculty of Nursing and Midwifery at the University of Sydney & the Faculty of Health University of Technology & Professor Jane Salvage, Director, ICN Global Nursing Leadership Institute 2020.

SITOGRAFIA

<http://www.fnopi.it/ecm/rivista-linfermiere/rivista-linfermiere-page-1- Articolo-3.htm>

<http://www.nursetimes.org/infermieri-difusione-retribuzione-europa/18414>

<https://unizkm.al/facolta-di-medicina/cdl-triennali/124-cdl-infermieristica>

<https://www.sharingtourism.it/team-vincente/leadership-situazionale/>

<https://www.professionelavoro.net>

<https://www.infermierionline.it>

